

Njoftim për koncentrim me të cilin BIG Energija Holdings Kft nga Hungaria do të fitojë kontroll të pavarur mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime ÇASICA SOLAR SHPK Shkup nga Republika e Maqedonisë së Veriut

(lënda nr. 08-115 nga viti 2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 18.08.2022, i plotësuar më 22.08. 2022, deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës dorëzohet një njoftim për përqendrim, i cili i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga BIG Energija Holdings Kft. me seli të regjistruar në rr. Marko 7.6 kati 8, Hungari mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime ÇASICA SOLAR SHPK Shkup me seli në adresën bul. ASNOM, nr.72-1/35, Shkup – Aerodrom- Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Ky akt është bazë për fitimin e kontrollit të pavarur nga ana e blerësit, prej shitësve të pjesëve prej 100% në Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime ÇASICA SOLAR SHPK Shkup, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila është themeluar dhe ekziston në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- **BIG Energija Holdings Kft** është 100% në pronësi të BIG Shopping centers Ltd. (në tekstin e mëtejshëm: BIG). BIG është një Holding kompanish, kryesisht në biznesin e patundshmërive me aktivitet në SHBA, Izrael, Serbi, Mal të Zi dhe Francë. BIG ndërton dhe investon në qendra tregtare ndërtesa afariste dhe qendra logjistike në mbarë botën, duke përfshirë 30 qendra në Izrael, 10 në SHBA, 9 në Serbi dhe shumë të tjera janë në ndërtim e sipër. BIG është një kompani e kotuar publikisht në bursën e Tel Avivit. BIG është përfshirë në indeksin TA-35 dhe përfaqëson një nga kompanitë më të mëdha të pasurive të paluajtshme në tregun izraelit me një pjesë prej më shumë se 3.0 bilion euro.

Në vitet e kaluara, BIG, përmes BIG Energija Holdings Kft., ka filluar të investojë në sektorin e energjisë elektrike përmes blerjes së pjesëve, gjegjësisht kompanive të tëra, dhe/ose përmes zhvillimit të projekteve të veta. Qarkullimi total i BIG Energija Holdings Kft. është në pjesën më të madhe nga pasuria e paluajtshme.

BIG Energija Holdings Kft. nuk është e pranishme dhe e regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe nuk është ende e pranishme në tregun e Maqedonisë së Veriut. Por , procedura është në vazhdim për themelimin e SHPK-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ÇASICA SOLAR SHPK është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti parësor i regjistruar i së cilës është prodhimi i energjisë elektrike. Kompania e synuar është ende në fazën e zhvillimit të projektit për ndërtimin dhe sigurimin e të gjitha licencave të nevojshme të centralit për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet diellore-fotovoltaikë dhe ende nuk ka filluar me prodhimin e energjisë elektrike. Kompania e synuar është themeluar në vitin 2022 dhe nuk ka gjeneruar qarkullim në vitin 2021, si viti që i paraprin vitit në të cilin është dorëzuar ky Njoftim. Do të thotë se nuk realizon asnjë qarkullim në tregun relevant në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

26.08.2022

Shkup